



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 21.12.2018)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:23 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli*</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
2. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
4. *Luljeta Laze, Drejtoreshë e ZABGJ-së.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
7. *Përfaqësues të EURALIUS-it.*
8. *Përfaqësuese e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.*

RENDI I DITËS:

1. Mbi transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.
2. Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të gjykatës.
3. Mbi informacionin e ish Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me situatën aktuale, problematikat dhe propozimet.

Naureda Llagami: Atëherë, çështjet që kemi sot për rend të ditës, po t'i referohemi axhendës, është së pari, "Mbi transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë". Së dyti, "Mbi miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të gjykatës", dhe së treti, "Mbi kërkimin e informacionit të ish Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë lidhur me situatën aktuale, problematika dhe propozime".

Atëherë, pse është ky rend i ditës?

Në eventualitetin që ne sot kemi mungesa të kryetarëve të gjykatave, është shumë e domosdoshme që të vlerësohet si do procedohet me drejtimin e këtyre gjykatave. Po t'i

referohemi kuadrit ligjor, kuadri ligjor ne na pengon të bëjmë transferime të përkohshme të këtyre dhe të bëjmë delegime të kryetarëve të gjykatave. Referuar ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, tashmë koncepti i drejtimit të gjykatës është përmes kryetarit, zëvendëskryetarit dhe këshillit të gjykatës. Në këtë situatë, u gjykua si gjëja më imediate, në kushtet që kryetar ne nuk mund të zgjedhim sepse ligji “Për statusin...” ka bërë një rregullim mjaft të detajuar dhe specifik në përzgjedhjen e kryetarëve, do të operojmë me zgjedhjen e zëvendëskryetarit, i cili në mungesë të kryetarit, plotëson të gjithë nevojën dhe ushtron të gjithë detyrat që duhet të kryejë kryetari.

Kjo lloj draft-rregullore është në zbatim të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, në zbatim të nenit 26 të këtij ligji dhe bashkëlidhur, ju lutem, keni rregulloren.

Ne do të veprojmë në fakt me shumë shpejtësi në këtë lloj situatë.

Pas miratimit të kësaj rregulloreje, do mundohemi që direkt, gjykatat që kanë probleme lidhur me largimin e kryetarëve, të operojnë në mënyrë sa më të shpejtë për përzgjedhjen e zëvendëskryetarit.

Problematikë që kemi është Gjykata e Pukës, e cila ka vetëm dy gjyqtarë, njërin e ka gjyqtarin e Pukës dhe një tjetër e ka të komanduar nga Shkodra. Për këtë gjykatë jemi vënë direkt në komunikim me kryetarin e Gjykatës së Shkodrës për të komanduar një gjyqtar tjetër në Pukë, me qëllim që të bëhet mbledhja e përgjithshme dhe të zgjidhet një zëvendëskryetar.

Jemi të detyruar të veprojmë në këtë lloj mënyre sepse ligji nuk parashikon opsion tjetër. Nuk mund të shkojmë dot më me komandim të drejtpërdrejtë. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund të veprojë më siç ka vepruar KLD-ja.

Këtë lloj qëndrimi, pasi e konsoliduam me stafin këtu, morëm mendim edhe të dy misionëve (EURALIUS-it dhe USAID-it), të cilët ishin me të njëjtin qëndrim me propozimin tonë.

Unë e kuptoj që është shumë shpejt dhe besoj që kjo do jetë situata e parë që do ju propozoj aktet këtu sepse besoj që në mbledhjet e tjera ne do kemi mundësi që të punojmë bashkë për aktet. Por në situatën që ishte imediate dhe shumë emergjente rregullimi i drejtimit të gjykatave, ne kemi operuar në mënyrën sa më të shpejtë të jetë e mundur.

Atëherë, çfarë thotë ligji?

Ligji thotë që ne nuk mund të zgjedhim dot kryetarë. Nuk kemi më komandime. Me ligjin e ri kemi vetëm caktime të përkohshme të magjistratëve dhe ka një procedurë shumë të ndërlikuar dhe nuk kemi më kryetarë. Nuk mund të përcaktojmë në mënyrë të përkohshme kryetarë. Me ngritjen e KLGj-së kemi ligjin “Për pushtetin gjyqësor” i cili na ka detyruar që drejtimi i gjykatës ka ndryshuar komplet funksionin e tij. Pra kemi kryetarin, kemi një zëvendëskryetar i cili janë produkt i mbledhjes së përgjithshme. Pra sot ne do fillojmë aplikimin e këtij rregullimi. Situata është që ne kryetarët nuk mund t’i zgjedhim dot sepse kryetarët, ligji “Për statusin...” ka disa rregullime shumë të posaçme, që jemi në pamundësi për të vepruar me këtë shpejtësi. Ndërkohë, sjellim në vëmendje që edhe vendimet e largimit nga komisioni i vetingut, nuk janë vendime përfundimtare. Pra ne nuk mund të veprojmë dot me hapjen e vendeve vakante për kryetarët. Ngërçin do ta zgjidhim nëpërmjet zëvendëskryetarit. Kjo është logjika.

Brunilda Kadi: Mundem?

Naureda Llagami: Patjetër!

Brunilda Kadi: Atëherë, mendoj që situata emergjente ka qenë edhe në kohën kur u veprua nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me komandimet sepse zgjedhja e personit që përfaqëson gjykatën është emergjente që orën e parë që gjyqtari që ka ushtruar këtë detyrën është shkarkuar. Sepse sipas ligjit, në atë moment ai nuk e ushtron më funksionin e gjyqtarit, rrjedhimisht edhe të kryetarit. Emergjencat se çfarë ka gjykata, të gjithë ne i dimë. Kështu që unë mendoj që nuk ka kohë për të bërë miratimin e rregullores dhe pastaj të thërritet e gjithë kjo procedura që është e parashikuar, e cila besoj kjo që është propozuar është në përputhje me ligjin. Mendoj që të gjithë ne kemi nevojë për kohë për të miratuar sepse ky është një akt normativ dhe nëse ne e miratojmë me nxitim, pastaj nuk ka sens që ta korrigjojmë më vonë, vetëm me arsyetimin që s’kishim kohë që të lexonim. Por ajo që është më emergjente për mendimin tim është që ne nuk kemi kohë që të veprojmë me këtë procedurë.

Çfarë do ndodhë, nëse sot në gjykatat që janë pa përfaqësues shkon një situatë emergjente, kush do nënshkruaj në emër të gjykatës sot, në këtë moment, në tre gjykatat që janë pa kryetar? Ka qenë kjo arsyeja pse është diskutuar dhe është vendosur edhe nga

Këshilli i Lartë i Drejtësisë që është vepruar me komandim. Që është një situatë e paparashikuar shprehimisht nga ligji sepse në kohën kur u bënë ligjet nuk u mendua kjo situatë. Kështu që unë mendoj që nuk mund të ecim me këtë procedurën për të miratuar rregullat dhe pastaj që të mblidhen këshillat e gjykatave e të respektohet e gjithë kjo rregullore për t'u zgjedhur zëvendëskryetari. Nuk e di se kush mund të japë përgjigje nga ju se çfarë ndodh sot në këtë moment në një gjykatë që është pa kryetar se kush do firmosë në emër të gjykatës. Bëhet fjalë, le të themi, për masat e sigurimit.

(Zoti Bici flet pa ndezur mikrofonin.)

Cili nënkryetar?

Kur? Tani! Sot! Në këtë moment!

Jo! Ju mund të veproni shpejt, por puna është që të bëhet kjo respektimi...

(Zoti Bici flet pa ndezur mikrofonin.)

Medi, të lutem, mund të flasësh me mikrofon? Që të mbaroj unë...

Ideja është tani, në këtë moment.

-Si mund të zbatohet kjo?

-Si do thërriten gjyqtarët?

-Kur do shprehet interesi?

-Kur do bëhet mbledhja e gjyqtarëve?

-Si do zgjidhet sot po ju pyes?

Ka shkuar në Gjykatën e Korçës një dokument urgjence që duhet të nënshkruhet nga kryetari. Kush do e mbajë përgjegjësinë?

Bëhet fjalë për shembull për masat e sigurimit. Sepse bëhet fjalë për të drejtat e njeriut.

Unë mendoj që duhet të procedojmë siç është ecur me komandimet dhe pastaj... Edhe që sot mund ta miratojmë këtë rregullore dhe të vijohet më tutje. Por sot ne duhet të komandojmë kryetarët e gjykatave që janë pa përfaqësues. Nuk jam kundër rregullores - që të kuptohemi, - në parim edhe për të vijuar më tutje. Faleminderit!

Ilir Toska: Me sa kuptova, kuptoj që kjo është zgjidhja më optimale në raport me ligjin, që të zgjedhim një zëvendëskryetar, që këshillat, gjyqtarët të zgjedhin një

zëvendëskryetar që duhet të jetë aty përherë, ndërkohë që kryetari, për sa kohë ka procedura, tashmë sipas ligjit, që kërkojnë kohë, mund t'i ngelet kohës.

Nuk kuptoj shqetësimin e Brunës sepse ku është emergjenca e qenies për dy ditë apo për një ditë, apo për pesë ditë e kryetarit.

Brunilda Kadi: Kur të vijnë përgjegjësitë pastaj, kuptohemi.

Ilir Toska: Nëse vazhdoni kështu, nuk është se kuptoj gjë.

Brunilda Kadi: Unë dhashë mendimin tim.

Ilir Toska: Mund të thoni se kush është emergjenca.

Brunilda Kadi: Okej, kur s'e dini juve, çfarë të them unë?!

Ilir Toska: Mund të ma thoni ju, se s'është ndonjë problem.

Kush është emergjenca që kryetari duhet patjetër...

Brunilda Kadi: Unë di që kryetarët e gjykatave çdo moment janë duke nënshkruar dokumenta. Dhe mendo, që të gjitha janë të rëndësishme. Pyetja ime është, -kush do t'i nënshkruaj këto dokumenta, që në këtë moment që jemi duke folur?

Ilir Toska: Po mund të më thoni kush janë dokumentat, se për këtë po ju pyes.

Brunilda Kadi: Ah, këtë pastaj e quaj nivel i ulët që ta diskutoj se kush janë dokumentat. Se çfarë nënshkruhet nëpër gjykata, të gjithë e dimë.

Ilir Toska: Po vazhduam kështu, nuk kemi për ta zgjidhur ndonjëherë.

Dritan Hallunaj: Po! Faleminderit!

Atëherë, në radhë të parë, ashtu siç u relatua nga ana e Kryetares, ne jemi në pamundësi që të kryejmë një komandim të tillë, pasi ligji nuk na e njeh një të drejtë të tillë. Unë çmoj që prezantimi i këtij drafti, pavarësisht se jemi në një kohë, pra që duhet të ishim njohur edhe pak më përpara, por për vetë emergjencën unë shoh që është mënyra më e përshtatshme për momentin që të vijojmë.

Për sa i përket detyrave që mund të ketë një kryetar, për afatin kohor, cilat janë ato, nëse kemi parasysh për fakte të veprimeve të ngutshme, që kanë të bëjnë me afatet, të gjitha gjykatat kanë të përcaktuar listën e gatishmërisë së gjyqtarëve dhe nuk ka më nevojë që të pritet firma e një titullari për të vepruar. Pra është lista e gatishmërisë, për ato veprime që janë të ngutshme.

Nëse është problemi për heqjen dorë, zgjidhet ajo, se ka një afat kohor për ta përcaktuar dhe pavarësisht kësaj rregulloreje që ne do miratojmë, nëse do miratohet sot, ne mund të vejmë në dijeni të paktën tre gjykatave të cilat kanë këtë pengesë, që të veprohet në mënyrë sa më të shpejtë, duke i urdhëruar, nëse mundemi – jo urdhëruar - por duke i nxitur ata që ta bëjnë këtë mbledhje sa më parë, mundësisht edhe ditën e nesërme.

Brunilda Kadi: Po kur do shprehet interesi dhe të gjitha këto gjërat?

Është një çështje sigurim padie. Është bërë kërkesa për të hequr dorë.

Dritan Hallunaj: Për ta futur në rrugë ligjore, që ne nesër-pasnesër të mos vijmë tek pjesa që u bë komandimi pa ligj apo... Të kemi një bazë ligjore për veprimet që po bëjmë. Pra thjesht... Unë mendoj të futemi në rrugën ligjore dhe të bëjmë miratimin e kësaj rregulloreje, që për mendimin tim... pastaj nëse do të ketë nevojë për ta ndryshuar edhe e ndryshojmë ndonjë gjë mbrapa, por për momentin, rruga më e mirë për ne është kjo. Nuk mund të bëjmë ne veprime të tilla, të asaj natyre, që nuk na i lejon ligji. Unë kaq kisha dhe jam gati që të votojmë këtë draft-rregullore. Faleminderit!

Naureda Llagami: Zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Në gjykimin tim personal, KLGj-ja sot nuk mund të marrë përsipër kompetenca që nuk i njeh ligji. Pavarësisht asaj çfarë ka bërë KLD-ja më përpara. KLD-ja ka përfunduar veprimtarinë e vetë. Që dje, vepron Këshilli i Lartë Gjyqësor, së pari. Së dyti, Në kushtet kur neve nuk komandojmë dot kryetarin, duhet të tregohemi pragmatist. Qëllimi ynë këtu është t'i japim zgjidhje situatave emergjente. Jemi përpara situatave emergjente. Kemi tre gjykata pa kryetarë. Në kushtet që ne nuk veprojmë dot për kryetarin, duhet të ndjekim rrugën tjetër nëpërmjet zëvendëskryetarit, duke qenë që pika 1 e rregullores, siç e lexoj unë, thotë: “Zëvendëskryetari i gjykatës ushtron kompetencat e kryetarit, në mungesë të tij”. Nuk veprojmë dot me kryetarin, të veprojmë me zëvendëskryetarin. Kështu që unë jam dakord që rruga e zgjidhjes të jetë nëpërmjet zëvendëskryetarit.

Brunilda Kadi: Sot nëpër gjykata mund të jetë një kërkesë për sigurim padie dhe gjyqtarit që i ka rënë çështja kërkon të heqë dorë. Nesër dhe pasnesër është e shtunë dhe e

diel. Të hënën... nuk e di si është imagjinata, se si do zbatohet kjo rregullorja edhe sikur të miratohet sot. Afati që duhet të zgjidhet kjo, i dini vetë afatet. Unë nuk e di se kush do mbajë përgjegjësi pastaj se çfarë do bëhet me atë padinë e atij qytetarit që do t'i cenohet një e drejtë themelore.

Naureda Llagami: Do doja t'ju informoja për diçka.

Ne e kuptojmë urgjencën dhe domosdoshmërinë e veprimeve që duhet të kryejmë dhe mbi të gjitha, ligjshmërinë e këtyre veprimeve sepse neve duhet të jemi shumë të kujdesshëm në këtë lloj... në hapat e parë që ky institucion do të bëjë.

Kur e kemi propozuar këtë projekt-rregullore, stafi mbështetës i KLD ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të informuar gjykatat përkatëse për zhvillimin mundësisht të kësaj mbledhjeje ditën e shtunë. Fakti që ne kemi bërë këtë draft-rregullore është diçka shumë mirë e konsultuar dhe janë marrë të gjitha masat që të organizohet kjo lloj situatë dhe që ditën e hënë të kemi zëvendëskryetarin në zbatim të kësaj rregulloreje dhe ditën e hënë, gjykatat që do kenë probleme, do jenë me zëvendëskryetarë dhe nuk do pengohet në asnjë mënyrë procesi dhe administrimi i drejtësisë. Kështu që, fakti që, unë mund t'ju ofroj kohën e duhur ta lexoni projekt-rregulloren, ta kuptojmë të gjithë bashkë këtu sepse e mirëkuptoj shqetësimin që është një dokument, mund të doni kohë që të reflektoni mbi këtë, por shqetësimin që keni lidhur me menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, ne jemi munduar të marrim masa me këto gjykata që të veprojnë sa më shpejt brenda uikendit (*weekend-it*). Sikurse Këshilli i Lartë i Drejtësisë, stafi i Këshillit do të veprojë për adaptimin e situatave infrastrukture këtu brenda Këshillit, po ashtu janë marrë masa të veprojnë sa më shpejt, në mënyrë që të hënën të jemi në përputhje të plotë me ligjin dhe mos të kemi pengesa gjatë proceseve.

Brunilda Kadi: Pra juve keni merakun se mos komandimi është i paligjshëm dhe nuk keni merakun që emërimi i këtyre zëvendëskryetarëve mund të jetë i paligjshëm, qoftë edhe procedura?!

Unë s'e di si do njoftohen gjyqtarët sot për nesër. Se tek kjo rregullorja, që besoj është parë ligji, thuhet që është e vlefshme kur janë 2/3. Nesër është e shtunë dhe të gjithë ata kanë të drejtën e botës të mos shkojnë nesër. Si do ta zgjidhni pastaj situatën? Sepse është e pavlefshme mbledhja.

Naureda Llagami: Atëherë, këtë situatë Këshilli ka marrë përsipër ta zgjidhi përmes lajmërimeve dhe përmes telefonatave dhe përmes detyrimit për të qenë në atë mbledhje. Është detyrë e çdo gjyqtari, i cili në situata të tilla, të reagojë me përgjegjshmëri dhe dinjitet ndaj këtyre situatave. Ne nuk jemi në situata normaliteti. Ne jemi në situata emergjence dhe në këtë situatë të gjithë ne reagojmë ndaj emergjencës. Kështu që ju ftoj që të reflektojme mbi projekt-rregulloren dhe çfarë mund t'i shtojmë për ta pasuruar dhe për

Brunilda Kadi: Ne s'e kemi njohur rregulloren.

Naureda Llagami: Këtë ju ftoj pra.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Për këtë ju ftoj që ta lexojmë bashkë, ta kuptojmë bashkë, ta pasurojmë.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Nuk duhet të lexojmë rregulloren, duhet të lexojmë ligjin, se këtu as formalisht...

Ta di përmendësh? Unë s'marr përsipër. Edhe kur e lexoj "Neni 1" të procedurën, hap Kodin dhe e lexoj. Nuk e mbaj dot përmendësh.

Brikena Ukperaj: Më fal! Mund të jap një opinion?

(Zonja Kadi dhe zonja Llagami flasin pa ndezur mikrofonat.)

Brunilda Kadi: Unë diskutova atë që është më thelbësore.

(Vazhdojnë diskutimet pa u ndezur mikrofonat.)

Alban Toro: A të them diçka?

T'i hedhim në votë të dy variantet, që mos të humbim kohë të diskutojmë.

Variantin e parë që diskutohet me komandime dhe varianti i dytë që propozohet me aktin rregullativ dhe e ndërpresim.

Brunilda Kadi: Me Gjykatën e Pukës si do zbatohet kjo rregullorja, se nuk kam asnjë lloj ideje?

Naureda Llagami: Edhe me Gjykatën e Pukës kemi marrë masat për personin që do të komandohet, do të transferohet sot.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: A është jashtë ligji që të komandohet?

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Do kemi transferim në bazë të nenit 44 të ligjit “Për statusin...” dhe ju ftoj që të lexojmë atë nen bashkë këtu tani dhe të kuptojmë edhe atë gjë.

Brikena Ukperaj: A mund të them diçka?

Naureda Llagami: Patjetër!

Brikena Ukperaj: Së pari njëherë ndaj mendimin që – edhe disa kolegë e thanë – është çështje ligji koncepti i mandatimit apo komandimit të një kryetari gjykate. Sigurisht që pozicioni i kryetarit të gjykatës është më shumë sesa të firmosë letra sepse ka shumë kompetenca të rëndësishme. Problemi është që nuk kemi një dispozitë ligjore që ne t’i referohemi dhe të themi që në bazë të kësaj dispozite do të komandojmë kryetarin e gjykatës.

Jam dakord me pjesën e... shpreh mendimin që duhet të operohet shpejt që Këshillat të zgjedhin zëvendëskryetarët e gjykatave, por kemi edhe një situatë tjetër që duhet ta kemi parasysh. Ne kemi shumë gjykata me kryetarë që u ka mbaruar mandati, që vazhdojnë dhe ushtrojnë funksionet, firmosin, ndërkohë që u ka mbaruar mandati. Po kështu kemi edhe shumë gjykata me kryetarë gjykatash të komanduar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ish KLD, për të cilën nuk jam në dijeni se si janë shprehur në këto vendime, dhe kam frikë se do kemi përballë një konflikt kompetencash pastaj midis zëvendëskryetarit dhe këtyre kryetarëve që vazhdojnë funksionet me mandate të mbaruara apo të komanduar nga KLD-ja. Sepse zëvendëskryetari do jetë i zgjedhur nga Këshilli, sipas ligjit të ri, ndërkohë që kryetarët vazhdojnë ushtrojnë funksionet pa mandat ose mbi bazën e një vendimi komandimi, që ne sot vendosëm që s’mund ta bëjmë sipas ligjit.

Ky ligj ka qenë edhe në atë kohë. Në atë kohë ka qenë ky ligj dhe kjo është edhe një çështje që duhet ta zgjidhim.

(Hyn në sallën e mbledhjes zonja Fatmira Luli.)

Naureda Llagami: Patjetër pra! Dhe këto janë të gjithë situatat që ne na presin përpara për t’i zgjidhur. Që neve të veprojmë me emërimin e kryetarëve të gjykatave, ne duhet të bëjmë aktet nënligjore për të vepruar për ato. Që ne të bëjmë këto aktet

nënligjore për të vepruar, ne duhet të mblidhemi të ndajmë punën për komisionet, pra është një proces që unë personalisht, me përgjegjësinë time, i kam vënë në listën e çështjeve prioritare. Sot ne po flasim për prioritetin që kemi tre gjykata që drejtohen pa kryetarë. Sot çfarë do bëjmë?

Kam bërë 10 lista që do i ndajmë bashkë për çështjet prioritare që kemi deri në 15 janar (kush janë çështjet prioritare që ne do veprojmë). Ndërkohë që sot është emergjente të diskutojmë zgjidhjen e problematikës së mungesës së kryetarëve dhe ajo që neve kemi peshuar drejt bashkë me stafin, bashkë me misionet, bashkë me kolegët, me disa që mund ta kem ndarë mendimin, është kush është instrumenti ligjor që do veprojmë në këtë rast dhe ne morëm kosto që do punojë Këshilli edhe të shtunë edhe të diel, bashkë me ato gjykata përkatëse, i kemi bërë telefonata, vetëm që të përdorim instrumentin e duhur ligjor. Asnjëri prej nesh nuk do që nesër-pasnesër të dalë tek një situatë që Këshilli vepron në kundërshtim me ligjin. Unë për vete nuk e dua këtë lloj situatë.

Brunilda Kadi: I kërkoj Kryetares që të hedhë në votim propozimin që bëra unë për komandimin. Të vijojmë me komandimin dhe pastaj me rregulloren në vijim. Unë propozoj që sot të tre gjykatat që janë pa kryetarë të komandohen kryetarë. Hidheni në votim, pastaj...

Naureda Llagami: Atëherë, jeni dakord me propozimin e bërë nga kolegja Brunilda që, të tre gjykatat të drejtohen përmes kryetarëve të vendosur përmes komandimit?

Fatmira Luli: Besoj që kjo ishte emergjenca që priste të zgjidhej ky Këshill, që të komandojmë kryetarët që janë të pezulluar dhe gjykatat që janë pa drejtues. Kështu që, jam dakord.

Naureda Llagami: Kush është dakord me propozimin?

Brunilda Kadi: Atëherë, unë jam pro, se e propozova. Se është për efekt të procesverbalit. Mirë është që të votoni me mikrofon.

Fatmira Luli: Edhe unë jam pro.

Naureda Llagami: Kalojmë në propozimin tjetër?

Lidhur me miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të gjykatës?

Maksim Qoku: Pro.

Dritan Hallunaj: Edhe unë jam pro.

Ilir Toska: Pro.

Alban Toro: Pro edhe unë.

Marçela Shehu: Pro. Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Brunilda Kadi: Atëherë, jam pro në parim, por duhet të na jepet një kohë minimale që ta studiojmë, se nuk mund të miratojmë një rregullore kështu meqë na erdhi nga stafi dhe hajde ta miratojmë. Kërkoj një kohë minimale edhe sikur të rrimë deri në 12 të natës që ta miratojmë.

Erjon Muharremaj: Numri i votave e miratoi tashmë rregulloren, kështu që.

Naureda Llagami: Atëherë, rregullorja u miratua me shumicën e votave.

...lidhet me transferimin e përkohshëm të një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Pse po kërkohet ky transferim?

Po kërkohet ky transferim që të krijohet një numër për përzgjedhjen e zëvendëskryetarit dhe për bërjen funksionale edhe të mbledhjes së përgjithshme.

Më lejo që t'ia jap fjalën pak Sekretarit të Përgjithshëm, të na japë një informacion të përgjithësuar mbi këtë çështje.

Pjerin Prendi: Atëherë, Drejtoria Juridike i ka nisur para një ore e-mail urgjent kryetarit të Gjykatës Shkodër, për të na dhënë një mendim lidhur me gjyqtarin i cili ka ngarkesë më të pakët dhe opinionin e tij nëse mendon se duhet transferuar përkohësisht një gjyqtar nga Gjykata e Shkodrës në Gjykatën e Pukës. Besoj që për punë minutash, 2-3 minuta vjen përgjigja dhe pastaj të vendosim ne këtu lidhur me transferimin apo jo të një gjyqtari.

(Në pritje të përgjigjes nga kryetari i Gjykatës së Shkodrës, Këshilli zhvillon pikën e tretë të rendit të ditës.)

Naureda Llagami: Atëherë, në pritje të informacionit nga Sekretari i Përgjithshëm, marrë shkas se një nga kërkesat që më është bërë nga kolegët është lidhur me situatën e problematikave që na pasqyrohet nga inspektori i përgjithshëm i ish KLD-së. Për këtë arsye vendosëm që t'i kërkohej ish inspektorit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë një informacion lidhur me situatën aktuale, problematikat dhe propozimet.

Jeni dakord?

E keni tek axhenda, të lutem.

Dritan Hallunaj: Ndjesë! Atëherë, një sqarim.

Për sa i përket një mendim dhe eventualisht një kërkesë apo një shkresë që na është paraqitur, një material që na është paraqitur dhe që mban datën 13.12.2018. Kjo për se bën fjalë nëse mund të orientohemi?

(Mikrofonat janë të fikur.)

Marçela Shehu: Më fal, kam përshtypjen që informacioni që ka referuar Kryeinspektorja është një nga temat që ne kemi diskutuar dhe që, domethënë e kemi diskutuar në takimet tona jo formale dhe kemi rënë dakord që ta diskutojmë dhe të arrijmë në një vendimmarrje, sepse me sa shikoj, bëhet fjalë pikërisht për ish inspektorët pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kështu që ndoshta duhet të merremi me këtë çështje, pa i kërkuar të gjitha problematikat që ka KLD-ja. Le t'i japim... Po pra, më të ngutshme... Besoj që kjo është një nga më të ngutshmet. Kështu që, t'i japim një përgjigje apo të marrim një mendim lidhur me këtë sepse ajo mund të kërkojë kohë, informacioni që do i kërkojmë inspektoret.

Naureda Llagami: Ne mund t'i lëmë edhe një afat që të na japë informacionin sepse është shumë imediate që të kuptojmë në çfarë shtate jemi tani. Pra është shumë imediate të kuptojmë jo vetëm statusin se çdo bëhet me inspektorët, por është imediate të kuptojmë çfarë letrash kanë ardhur nga vetingu për vlerësim, ku është situata dhe ne duam një pasqyrë. Personalisht unë tani jam vënë në dijeni me këtë. Unë dua që kur ta fusim për vlerësim tek mbledhja e radhës që do e vendosim këtu bashkë, ne ta kemi informacionin dhe ju ta keni lexuar paraprakisht. Në qoftë se ngutja për kryetarin ishte diçka që ndodhi dje dhe sot, kjo nuk është një ngutje e tillë. Kjo është një ngutje që ne duhet të vlerësojmë situatën që kemi aktualisht me punën dhe veprimtarinë e Inspektoratit

dhe më pas statusi i tij. Kështu që, jo më kot e futa në rendin e ditës, që informacioni të jetë një informacion i plotë, ku të diskutohen të gjithë problematikat dhe ne do të ndalojmë pikë më pikë në atë lloj informacioni.

Marçela Shehu: Jo, unë mendoj që ka një lloj ngutshmërie, prandaj dhe është paraqitur paraprakisht sepse janë funksionarë të caktuar, janë inspektorë të cilët tashmë u ka mbaruar mandati - unë nuk jam thelluar në shkresë - dhe të cilët presin të dinë se a do të ketë vazhdimësi puna e tyre. Kështu që për mua kjo është ngutje. Nuk ka pse mos të konsiderohet ngutje. Mund të ketë situata të tjera akoma edhe më të ngutshme që nuk i dimë, por mendoj që kjo është një situatë që duhet ta marrim në konsideratë, pra ta fusim në...

(Një anëtar ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Më fal, pse mos ta fusim këtë në rendin e ditës dhe kur të sjellin informacionin që mos të ketë ngutshmëri, pastaj i trajtojmë edhe pikat e tjera. Ku është problemi që ta trajtojmë këtë? Për ne mund të mos jetë ngut por është për ata ngut. E kupton?

Janë ca njerëz që sot janë pa punë. Kështu i bie, e thënë shkurt.

A duhet ta konsiderojmë si ngutshmëri këtë pjesë apo jo?

Po, pse jo. Ose në mbledhjen tjetër më të afërt. Këtë po diskutojmë. Ndoshta jo ta diskutojmë sot. Por ta marrim në konsideratë sot për ta futur në mbledhjen tjetër të ardhshme.

Naureda Llagami: Unë jua thashë. Ky informacion më ka ardhur tani në tavolinë. Dhe që t'jua shpjegoj ju se çfarë ka informacioni... Në qoftë se draft-rregulloren dhe të tjera unë mund t'jua them me fjalët e mia se çfarë përmban, për këtë nuk kam dijeni se çfarë përmban. Më erdhi tani, m'u shpërnda tani nga stafi. Kështu që unë nuk marrë përsipër t'ju shpjegoj çfarë ka informacioni, çfarë baze ligjore dhe si. Ama unë ju garantoj që në momentin që unë kam një pasqyrë të qartë dhe lexoj këtë informacion bashkë me informacionin tjetër, në mbledhjen e ardhshme unë ju shpjegoj situatën që është me inspektorët.

Marçela Shehu: Dakord, por ta fusim në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme.

Naureda Llagami: Patjetër që po. Patjetër!

Do jetë imediate. Është çështje imediate.

Brikena Ukperaj: Sepse ata vërtetë kanë një shqetësim për shkak të ligjit sepse janë të ndarë në inspektorë që janë marrë me vlerësimet, me vetingun dhe inspektorë që janë marrë me procedimet dhe ligji vetëm një pjesë të tyre i atashon pranë KLGJ-së, ndërsa për të tjerët thotë që do të kalojnë automatikisht deri në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe kjo procedurë nuk dihet sa do zgjasë. Dhe unë mendoj që është serioze, i gjithë shqetësimi që ata kanë. Kështu që, në mbledhje, përveç kësaj, ta kemi paraprakisht, që të mos jemi në këtë situatë që, na erdhi sot dhe duhet të shprehemi sot. Ta kemi paraprakisht të gjithë situatën.

Naureda Llagami: Prandaj ju ftoj që më lejoni që të marrë informacionin e duhur, t'ju shpërndaj në kohën e duhur dhe të bëjmë një vlerësim të drejtë. Sot është mbledhje për shkak të situatës emergjente që kemi në tre gjykata. Në momentin që neve krijojmë një ide mbi situatën e inspektorëve nga informacioni dhe ju t'i keni studiuar dhe lexuar, patjetër që do jetë në rendin e ditës dhe do jetë çështje prioritare. Kjo është ndjeshmëria e të gjithëve këtu nga ne.

Brunilda Kadi: Atëherë, unë mendoj që pjesa më emergjente për të zgjidhur këtë situatën ka të bëjë me procesin e rivlerësimit sepse në çdo moment në këtë Këshill vijnë komunikime nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndoshta edhe nga ai i apelimit dhe dikush duhet t'i kthejë përgjigje për këtë pjesë. Ata çdo sekondë komunikojnë dhe ka procedura siç i kanë procedurat, qoftë për shortet, qoftë për kthim përgjigje, informacione që kërkojnë. Kështu që është shumë emergjente.

(Në këtë moment të mbledhjes, Këshilli i rikthehet pikës së parë.)

Naureda Llagami: Kryetari i Gjykatës Shkodër, zoti Arben Zefi ka propozuar për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, zotin Andri Ymeri, duke bërë edhe një vlerësim në përputhje me... Ky është propozimi. Tani, bëji një fotokopje dhe shpërndaja të gjithëve.

Dritan Hallunaj: Mund ta shohim edhe shkresën.

Naureda Llagami: Po, patjetër!

(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat ndërkohë që shkresa shumëfishohet për anëtarët e Këshillit.)

Pjerin Prendi: Për të zgjidhur këtë situatë mund t'i referoheni kësaj baze ligjore. Në të kundërt pastaj, nuk zgjidhet situata e Pukës. Pra vetëm tek pika 2 e nenit 46.

Brunilda Kadi: Na duhet edhe vjetërsia.

Pjerin Prendi: Vjetërsinë e kemi ne këtu. E marrim.

Naureda Llagami: Zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Duke u konsultuar edhe me ligjin edhe pikërisht me nenin 46 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarit", paragrafi i parë thotë që: "...i cili përmbush kriteret për t'u transferuar, për t'u ngritur... të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion". Pra duhet pëlqimi nga vetë personi, nga magjistrati. "Në këtë rast, -thotë, *Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit*". Pra, mendimi i kryetarit vjen... Prandaj ne duhet të kemi edhe pëlqimin e këtij apo jo.

Brunilda Kadi: S'ka dhënë asnjë pëlqimin. Jemi tek pika 2 tani.

Dritan Hallunaj: Po mirë. A i është kërkuar? Këtë po them. A i është ofruar njeri që t'i japë pëlqimin dhe nuk është dhënë?

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Bruna, a e di ti apo e dinë ato?

Ta thonë ata pra, se nuk e di.

Brunilda Kadi: Okej! Por e thanë.

Dritan Hallunaj: Pra, është ezauruar pika e parë, që të kalojmë pastaj tek pikat e tjera? Në dijeni tuaj.

Pjerin Prendi: Kemi një praktikë të tillë të mëparshme. Gjithsesi, sa për analogji.

Asnjëri nga gjyqtarët nuk pranon që të shkojë në Pukë dhe askund tjetër.

Dritan Hallunaj: Atëherë, të na jepet një shënim që është bërë e ditur kjo gjë dhe pastaj nga pika 1, kalohet tek pika 2.

Pjerin Prendi: Nuk është kërkuar për shkak të emergjencës. Sot gjithë ditën kemi që në 8:00 të mëngjesit që merremi me këtë problematikë. Sepse kishim shkarkimin e Pukës dhe erdhi shkarkimi me radhë i Korçës, i Beratit dhe kështu që është një emergjencë që edhe ne jemi në të tilla kushte.

Naureda Llagami: Zonja Shehu, po!

Marçela Shehu: Tani ne, e filluam të gjithë diskutimin edhe për miratimin e rregullores për zëvendëskryetarët, duke u shkrehur që ne do marrim të gjitha vendimet duke u bazuar në ligj. Pra nuk bëmë komandime të përkohshme të kryetarëve sepse menduam që ligji sot na kërkon në mënyrë specifike këtë procedurë ligjore, që ndonëse mund të na marri pak më shumë kohë, është ligjore në përputhje me ligjin. Tani, nuk kemi pse të cedojmë ne nga ligji, pra neni 46 vendos ca kritere se si bëhet transferimi i përkohshëm. Kështu që, pavarësisht nga praktika dhe nga emergjenca ne të marrim të gjithë kohën e duhur, për mendimin tim, që të realizohet e gjithë procedura në përputhje me ligjin. Të ftohen të gjithë gjyqtarët për të shprehur mendimin. Të dokumentohet fakti që asnjëri nga ata nuk ka dhënë pëlqimin. Të merret mendimi i kryetarit. Të kalojmë pastaj tek kriteret që parashikon pika 2 dhe të formalizohet parashikimi ligjor i pikës 2. Pra nuk mund të flasim më “-na tha kryetari në telefon”, apo “-na çoi e-maile”. Unë jam dakord që çdo gjë të jetë e dokumentuar, bazuar në ligj. Ky është mendimi im.

Maksim Qoku: Më fal! Pse mos t’i referohemi në fund shkresës që thotë: “Nisur nga këto të dhëna, duke marrë parasysh eksperiencën, ngarkesën e punës, kritere për t’u transferuar...”. Përse nuk u dashka të prezumojmë ne që është marrë edhe pëlqimi ose jo? Është shkresë e mbyllur kjo. Ju nxirrni ekuivokun, kërkon përjashtimin - çuditërisht, gjithmonë hipotetike - ndërkohë që thotë: “Nisur nga këto të dhëna, duke marrë parasysh eksperiencën, ngarkesën e punës, kritere për t’u transferuar...”, pra gjë që nënkupton që ata e kanë debatuar, e kanë folur. Nuk është marrë pëlqimi dhe kanë kaluar në pikën 2. Mendojmë që mos të zgjatemi kot.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Ligjin e lexojmë vetë.

Maksim Qoku: Prezumimi është i tillë. Nëse do të ishte mungesa e pëlqimit, do të ishte e shprehur. Fakti që kanë kaluar tek pika 2 dhe është gjetur me këtë kriter, mendoj që është prezumuar.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Jemi në pikën 2. Por sesi lexohet neni...

Marçela Shehu: Unë mendoj këtë. Nëse shkresa do të ishte e qartë dhe të përmbushte ato kritere që unë citova, unë nuk kisha asnjë lloj kundërshtimi që shkresa të

konsiderohej, por në interpretim të shkresës, me aq sa unë e kuptoj, nuk shikoj që kryetari ta ketë ezauruar këtë procedurën. Pra unë nuk shikoj që kryetari ka referuar që, ka mbledhur gjyqtarët, e ka diskutuar, i ka marrë mendimin, etj., etj. Mua më duket mendim më shumë personal dhe vlerësim personal i kryetarit. Kështu që unë mendoj që ka nevojë për një komunikim pak më të gjatë dhe më të detajuar.

Brikena Ukperaj: Mund të propozoj diçka?

Neni 46 “Transferimi i përkohshëm” nuk bën fjalë vetëm për transferimin e detyruar. Që të kalojmë tek transferimi i detyruar dhe kur asnjë s’jep pëlqimin, duhet ta respektojmë procedurën siç e parashikon ligji. Prandaj, ne si Këshill, se thotë Këshilli, nuk kemi bërë ndonjë shpallje për t’i kërkuar magjistratëve ose gjyqtarëve të Gjykatës së Shkodrës se kush nga këta jep pëlqimin që të shkojë në Pukë. Ky është hapi i parë i procedurës, që duhet të bëjmë, që të shkojmë tek tjetra. Nëse ata, asnjë nga ata nuk do të japë pëlqimin, pastaj jemi të detyruar të bëjmë transferimin pa pëlqim.

Naureda Llagami: Zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Në vijim të asaj që thanë edhe kolegët.

Ideja e transferimit të përkohshëm që është vendosur në ligj ka përcaktuar edhe ca kritere, pra ka një radhë pune, duke filluar nga propozimi apo vetë propozimi, pastaj në pikën 2 vijohet me, një nga paragrafët thotë: “Ky magjistrat duhet të jetë me përvojën më të pakët se magjistratët në atë gjykatë”. Në rastin konkret mua nuk më rezulton e tillë, pasi duke qenë pjesë e sistemit – e njoh – nuk është se ndodhet në kriteret pra që të jetë me përvojën më të paktë. Prandaj, edhe ngarkesa... Nuk duhet të mjaftohemi vetëm me një shkresë që ka ardhur nga kryetari i gjykatës i cili propozon... Pikërisht! Duhet ta shtrojmë dhe është edhe diçka tjetër që, kur të arrijmë tek pjesa e transferimit të detyruar, se për transferim të vullnetshëm, për të shkuar nga gjykata e rrethit Shkodër në gjykatën e rrethit Pukë, kam përshtypjen që nuk del asnjë dhe duke qenë një kriter diskriminues për gjyqtarët, të jemi shumë të kujdesshëm ne si Këshill, që ta respektojmë ligjin pikë më pikë, ashtu siç është, dhe nëse i bëjmë këto gjëra, mos të lejmë shteg apo që në mbledhjen e parë që ne të shkelim diçka për hir të një emergjence apo... Prandaj t’i ndjekim hapat/procedurat ashtu siç janë në ligj, në një kohë, mund të themi, pak më të shpejt, pra me disa veprime më të shpejta. Meqenëse edhe nesër është lënë zgjedhja, mbledhja për

zëvendëskryetarin e gjykatës, mund të vijohet edhe me këto procedurat dhe pastaj do të jetë po Këshilli që ta vlerësojë nëse do shkojë iks gjyqtar apo... Pra ta mbyllim proceduralisht, të jemi në rregull ne. Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë propozim konkret?

Të komunikojmë sërish me kryetarin e gjykatës dhe t'i themi që të lutem zbato procedurën lidhur me këtë?

Medi Bici: Propozimi im, e thashë që në fillim që transferimi i detyrueshëm lejohet/bëhet. Por ama jam dakord me Brunën edhe me Tanin që duhen zbatuar të gjitha kriteret e pikës 1, pra a është marrë mendimi, një, dhe e dyta... domethënë a është marrë mendimi i gjyqtarit, dhe e dyta, kush është gjyqtari më i ri, që të kalojmë tek... Statistikat nuk duhen.

Këto dy kërkesa besoj që duhen plotësuar paraprakisht para se të marrim vendimin.

Naureda Llagami: Lidhur me statistikat, po t'i referohemi shkresës, ne na rezulton kush është gjyqtari me më pak ngarkesë. Ngarkesën e thotë.

(Anëtarët flasin njëherësh pa ndezur mikrofonat.)

Jo vjetërsinë. Po flasim për ngarkesën.

Brikena Ukperaj: Kjo tregon ngarkesën që ka aktualisht gjyqtari, e para.

Vjetërsinë, kemi informacionet nga...

(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Erjon Muharremaj: Pika 2 kriteret i ka kumulative. Ngarkesë më të ulët dhe njëkohësisht me përvojën më të pakët si magjistrat. Kështu që janë që të dy kriteret.

(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Zonja Kryetare, mund të them diçka?

Tani, kur përmend termin kumulative, nënkuptohet që fillimisht shikohen gjyqtarët me përvojën më të ulët dhe midis tyre ai që ka ngarkesën më të pakët. Unë nuk besoj se ka ndonjë vështirësi.

Marçela Shehu: Nuk lidhet me magjistratin specifik. Edhe pika 1 thotë, Këshilli mund t'i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët. Pra jo gjyqtarit me ngarkesën më të ulët. Gjykatës.

Erjon Muharremaj: Po në rastin konkret, nëse është Gjykata e Sarandës me ngarkesën më të ulët, ai duhet të shkojë në Pukë?

Marçela Shehu: Po! Ose Gjykata e Burrelit.

Erjon Muharremaj: Okej, po të jetë se është Saranda.

Marçela Shehu: Jo, dua të them që mos të bazohemi tek numri i çështjeve që ka çdo gjyqtar. Ligji nuk thotë këtë. Ligji thotë gjykata me më pak ngarkesë. Unë kështu e kuptoj ligjin të paktën. Apo jo? Për shembull Burreli nuk ka ngarkesën e Lezhës dhe të Shkodrës. Nuk e ka. E kam me statistikë. Unë kam gjykuar në të gjithë veriun. Kështu që unë e di sa ka njëra dhe sa ka tjetra.

Unë jam dakord me Shkodrën, por ligji nuk na kërkon gjyqtarin... Jo detyrimisht. Këtë po them.

Dritan Hallunaj: Nëse më lejoni, a mund të bëjë një propozim tjetër që të shohim ngarkesën e një rrethi gjyqësor, të një gjykate të një rrethi gjyqësor tjetër, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është shumë e ngarkuar dhe vetë ligji, neni 46 nuk thotë shprehimisht që të jetë nga gjykata më e afërt por thotë nga gjykatat me ngarkesën më të ulët. Prandaj unë çmoj që të shohim nëse ka ndonjë mundësi nga një gjykatë tjetër, jo nga Gjykata e Shkodrës.

Marçela Shehu: Unë jam dakord, vetëm duhet të shikojmë gjykatat që kanë mbi 4 gjyqtarë. Sepse gjykatat me 4 gjyqtarë nuk mund të transferosh diku sepse nuk realizohet procesi pastaj, nuk mund të zhvillohet gjykimi në atë gjykatë.

(Nga anëtarët pyetet për Gjykatën e Burrelit.)

Burreli 3 gjyqtarë ka.

Naureda Llagami: Lidhur me... Atëherë, kemi çështje për diskutim. Nëse do vendoset që magjistrati i cili do të transferohet do të jetë nga gjykata brenda të cilit rrethit/juridiksionit është Gjykata e Pukës, që i bie Gjykata e Shkodrës? Po apo jo? Apo do jetë nga një gjykatë tjetër?

Fatmira Luli: Të flas unë?

Unë nuk jam për Shkodrën, unë jam për gjykatën...

Naureda Llagami: Do ta bëjmë me votim.

A kemi sugjerim tjetër?

Fatmira Luli: Unë mbështes sugjerimin e Dritanit, që nuk do shohim gjykatën e Shkodrës, por gjykatat që kanë ngarkesën më të ulët. Kështu e thotë ligji.

Naureda Llagami: Okej! Atëherë, fillojmë votimin?

Mbaje pak shënim. Gjykatat që kanë ngarkesën më të ulët. Propozimi, jo më pak se 4 gjyqtarë.

(Anëtarët diskutojnë njëherësh.)

Atëherë, në fakt Iliri ka të drejtë. Ne duhet të votojmë propozim konkret. Kemi Shkodrën propozim konkret të sugjeruar, kemi edhe një gjykatë tjetër.

Fillojmë. Kush është dakord me Shkodrën?

Maksim!

Maksim Qoku: Dakord jam.

Brunilda Kadi: Unë nuk mund të votoj për Shkodrën sepse nëse do respektojmë dispozitën, duhet të gjejmë gjykatën me ngarkesë më të vogël. S'ka kuptim kjo tani. Ç'është kjo? Votim për Shkodrën.

A e shtymë komandimin e gjyqtarëve dhe projektin që mos shkelim ligjin?

Mendoj që as në këtë rast mos e shkelim ligjin.

Dritan Hallunaj: Nuk jam dakord. Kundër.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Edhe unë dakord për Shkodrën.

Fatmira Luli: Unë them të respektohet ligji. Nuk jam dakord për Shkodrën për gjykatën me ngarkesën më të ulët.

Marçela Shehu: Kundër. Domethënë jam dakord me variantin që duhet respektuar përcaktimi i gjykatës me ngarkesë më të ulët.

Naureda Llagami: Shkodër apo jo?

Marçela Shehu: Shkodër, jo!

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

(6 vota pro për Gjykatën e Shkodrës.)

Ju lutem stafit, një e-mail të gjithë gjyqtarëve të Shkodrës. Kush nga këto gjyqtarë, në zbatim të nenit 44, shpreh pëlqimin për të qenë i transferuar në Gjykatën e Pukës përkohësisht.

Ju lutem, shpejt! Duke i dhënë edhe një afat brenda një orari të caktuar.

(Ndërkohë nga ana e administratës së Këshillit u dërgohet një e-mail të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Shkodrës që nga ana e tyre të jepet apo jo pëlqimi për transferimin përkohësisht në Gjykatën e Pukës. Pas përgjigjeve të marra, Këshilli rifillon mbledhjen.)

Naureda Llagami: Vazhdojmë?

Atëherë, pas komunikimit me shkrim nga ana e kryetarit të Gjykatës së Shkodrës, i cili na bëri me dije që nga trupa gjyqësore asnjë nuk kishte shprehur pëlqimin për t'u transferuar në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Pukës, mendoj që neve mund të vazhdojmë me përcaktimin në përputhje me nenin 46 të ligjit "Për statusin", gjyqtarin të cilin do ta transferojmë në Gjykatën e Pukës.

Propozimi, duke vlerësuar kriteret ligjore, është gjyqtari Besmir Stroka i cili ka 4 vite në detyrë. Jeni dakord me propozimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër, pasi ka të bëjë me vendimin që u shpreha më përpara, duhet të ishte zgjedhur nga gjykata me ngarkesë më të vogël.

Dritan Hallunaj: Edhe unë jam kundër, duke shprehur atë mendim që tha edhe kolegja, pasi isha me mendimin që gjykata që ka ngarkesën më të vogël. Faleminderit!

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundër, pasi shpreha edhe mendimin që duhej të ishte zgjedhur nga gjykata që ka ngarkesën më të vogël.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Atëherë, me shumicë votash, gjyqtari Besmir...

Medi Bici: Nuk votove.

Naureda Llagami: Pro.

Me shumicë votash, gjyqtari Besmir Stroka do të transferohet në mënyrë të përkohshme pranë Gjykatës së Pukës.

(Këshilli i rikthehet pikës 3 të rendit të ditës, e cila është trajtuar më herët.)

Para se ta mbyllim, kisha edhe një sugjerim të dhënë nga kolegët që, lidhur me pjesën e situatës së Inspektoratit pranë ish KLD, paralelisht me informacionin që do përgatitet nga Kryeinspektorja, do i luteshim misionit EURALIUS dhe USAID të na jepnin një opinion lidhur me statusin ligjor të kësaj strukture, duke na rekomanduar opsione dhe zgjidhjet për situatën ligjore që ndodhemi përpara. Në momentin që ne do t'i kemi këto dy dokumente, atëherë do t'i përfshijmë në rendin e ditës në mbledhjen më të shpejtë.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen, mbledhja konsiderohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor